

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

1. OBJEKTI I PROCEDURËS:

BLERJE PANELE SANDUIC

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44175000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

2 496 000 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit komisoni pasi u njoh me objektin e prokurimit, bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, bazuar ne manualin e cmimeve te ndertimit 2023 dhe analizave teknike tw miratuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë grupi I punws ka bërë përlllogaritjen e vlerës limit te kontrates.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Në zbatim të nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata ”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës Procedurë e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet

Argumentimi: *Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e fundit (duke përfshirë edhe kështet e maturuara për vitin 2026, duke pasur në vëmendje parashikimet e ligjit 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", I ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitet e vetqeverisjes vendore), për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kështeteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti Teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar.

Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar duhet të vertetohet lidhje midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, eëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.


Argumentimi: *Autorizimi i prodhuesit është dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qënë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.*

Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të secilit zë.

SPECIFIKIME TEKNIKE


Nr Përshkrimi	Specifikimi Teknik
1 Tipologjia	Panel sanduiç termoizolues
2 Përdorimi	Mbyllje anësore dhe/ose mbulim magazine
3 Përmasat	1 m x 15 m
4 Trashësia	50 mm
5 Ngjyra	E bardhë RAL 9002 ose ekuivalente
6 Materiali	Çelik i galvanizuar i paralyer
7 Trashësia e lamarinës	Min. 0.45 mm
8 Izolimi	Poliuretani PUR/PIR ose ekuivalent
9 Dendësia e izolimit	Min. 38–40 kg/m ³
10 Koeficienti termik	$U \approx 0.42 \text{ W/m}^2\text{K}$
11 Gjerësia efektive	1000 mm
12 Gjatësia	Sipas kërkesës deri 15 m
13 Mënyra e lidhjes	Sistem mashkull-femër
14 Fiksimi	Vida vetëfiletuese të galvanizuara
15 Rezistenca	Kundër lagështirës dhe korrozionit

Pamje Ballore



Prerje Tërthore - Trashësi 50 mm

Fletë llamarine e lyster



Fletë llamarine e lyster

Panelet sanduiç me trashësi 50 mm prodhohen zakonisht sipas standardit EN 14509 dhe përdoren për magazina, depo, objekte industriale dhe struktura prefabrikate.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", specifikimet teknike janë hartuar në funksion të përmbushjes së nevojave konkrete të autoritetit kontraktor, duke respektuar parimet e konkurrencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike të përcaktuara për panelet sanduiç termoizoluese janë vendosur mbi bazën e kërkesave funksionale, të performancës dhe jetëgjatësisë së materialit, duke synuar sigurimin e një produkti cilësor, rezistent ndaj kushteve atmosferike dhe të përshtatshëm për përdorimin e parashikuar.

Përcaktimi i tipologjisë si panel sanduiç termoizolues është i domosdoshëm për të garantuar izolimin termik dhe mbrojtjen e objektit nga ndikimet atmosferike.

Trashësia 50 mm është përcaktuar si minimum teknik i nevojshëm për të siguruar qëndrueshmëri mekanike dhe performancë të pranueshme termoizoluese.

Materiali prej çeliku të galvanizuar dhe të paralyer siguron mbrojtje ndaj korrozionit, rezistencë ndaj lagështirës dhe jetëgjatësi të shtuar të produktit.

Trashësia minimale e llamarinës 0.45 mm është përcaktuar për të garantuar rezistencë strukturore dhe për të shmangur deformimet gjatë transportit dhe montimit.

Izolimi me poliuretan PUR/PIR ose ekuivalent siguron koeficient të lartë izolimi termik, efikasitet energjetik dhe reduktim të humbjeve të energjisë.

Dendësia minimale e izolimit 38–40 kg/m³ është përcaktuar për të garantuar qëndrueshmëri mekanike, performancë të izolimit dhe jetëgjatësi të produktit.

Koeficienti termik $U \leq 0.42 \text{ W/m}^2\text{K}$ siguron nivel të përshtatshëm të izolimit termik dhe përmbush kërkesat e eficiencës energjetike.

Gjerësia efektive 1000 mm, gjatësia sipas kërkesës deri në 15 m dhe sistemi i lidhjes mashkull-femër janë karakteristika standarde të tregut, të nevojshme për montim të sigurt, minimizim të humbjeve dhe garantim të vazhdimësisë së izolimit.

Fiksimi me vida vetëshpuese të galvanizuara dhe kërkesa për rezistencë ndaj lagështirës dhe korrozionit janë të domosdoshme për garantimin e qëndrueshmërisë së investimit në kohë.

Ngjyra e bardhë RAL 9002 ose ekuivalente është përcaktuar për arsye estetike dhe funksionale, duke lejuar njëkohësisht ofertimin e produkteve ekuivalente, në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

Specifikimet e mësipërme nuk kufizojnë konkurrencën dhe nuk favorizojnë asnjë markë, prodhues apo operator ekonomik të veçantë, pasi janë bazuar në standarde të njohura të tregut dhe shoqërohen me termin "ose ekuivalent" kur është e nevojshme.

Ato përfaqësojnë kërkesat minimale teknike që duhet të plotësojë produkti për të garantuar funksionalitetin, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e investimit.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

NJESIA E PROKURIMIT